

Sipas nenit 36 të Ligjit për qasje të lirë në informatat me karakter publik ("Gazeta z. e R.M.V. nr.101/2019) Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut me seli në Bulevardin Krste Misirkov p.n., telefoni kontaktues 02 3136-044, faks 02 3237 – 538, e- mail: info@vsrm.mk dhe fidaije.alidemi@vsrm.mk, përmes UD Kryetari të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut Mr. Faik Arslani dhe personin zyrtar të poseduesit të informatave Fidaije Alidemi, përgatiti siç vijon:

RAPORT VJETOR
(nga 1.01.2019 deri më datë 31.12.2019)

1. Të dhënat për personat zyrtar të caktuar për ndërmjetësim me informatat te poseduesit e informatave;

Fidaije Alidemi- bashkëpunëtore gjyqësore,
e-mail : fidaije.alidemi@vsrm.mk

2. Numri i kërkesave të pranuar;

Në periudhën prej datës 01.01.2019 deri më datë 31.12.2019 në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut janë pranuar gjithsej 30 (tridhjetë) kërkesa për qasje të lirë në informatat me karakter publik, nga të cilat: 13 (trembëdhjetë) kërkesa me shkrim, 16 (gjashtëmbëdhjetë) kërkesa të parashtruara në formë elektronike dhe 1 (një) kërkesë e parashtruar me gojë, për të cilën sipas Ligjit për qasje të lirë në informatat është përgatitur shënim zyrtar.

3. Numri i kërkesave të përgjigjur pozitivisht:

Nga gjithsej numri i kërkesave të pranuar nga 01.01.2019 deri më 31.12.2019, për të gjitha 30 (tridhjetë) kërkesat është vepruar dhe përgjigjur pozitivisht.

4. Numri i kërkesave të refuzuara dhe të anuluar me theksimin e arsyeve për çdo kërkesë të refuzuar ose të anuluar;

- nuk ka

5. Numri i kërkesave jo të përgjigjur;

- nuk ka

6. Numrin e ankesave të paraqitura kundër vendimeve të shkallës së parë (aktvendimet e poseduesve të informatave, me përshkrim të vendimit, si dhe përcaktimi i arsyeve për vendimin e marrë në rast të refuzimit të serishëm të informatës së kërkuar);

Gjatë vitit 2019 nga ana e Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informata me karakter publik, në Gjykatën supreme të RMV janë ridërguar gjithsej dy (2) ankesa në lëndët për kërkesë të informatave me karakter publik, për të cilat ka vepruar Gjykata supreme e RMV.

-Në lëndën e parë, për kërkesën për qasje të lirë në informata me karakter publik, të parashtruar më datë 18.03.2019, Gjykata supreme e RMV u përgjigj pozitivisht, me Përgjigje të kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik më datë 15.04.2019, të dorëzuar kërkuarit – gazetar, përmes postës elektronike, sipas kërkesës së parashtruar. I pakënaqur nga përgjigja e marrë, kërkuari ka parashtruar ankesë përmes Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, të cilën i njëjti e ridërgoi në Gjykatën supreme me kërkesë që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit (24.04.2019) për tu deklaruar për ankesën dhe për ti dorëzuar shkresat e lëndës. Më datë 02.05.2019, në Komisionin për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik është dorëzuar Përgjigje e ankesës dhe shkresat e lëndës.

-Në lëndën e dytë, me kërkesë për qasje të lirë në informatat me karakter publik, të parashtruar më datë 11.07.2019, Gjykata supreme e RMV u përgjigj pozitivisht, me Përgjigje të kërkesës për qasje të lirë në informatat me karakter publik më datë 19.07.2019, dorëzuar kërkuarit – person fizik, me postë, sipas kërkesës së parashtruar. I pakënaqur nga përgjigja e marrë, kërkuari ka parashtruar ankesë përmes Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik, të cilën i njëjti e ridërgoi në Gjykatën supreme me kërkesë që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit (15.08.2019), për tu deklaruar për ankesën dhe për ti dorëzuar shkresat e lëndës. Më datë 22.08.2019, në Komisionin për mbrojtjen e të drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik është dorëzuar Përgjigje e ankesës dhe shkresat e lëndës.

7. Numri i ankesave të pranuar me vendim të Agjencisë;

1 (një) ankesë e pranuar me vendim të Agjencisë

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë është regjistruar ankesë nën SPI.nr. 21/2018 – 3 nga 22.06.2018, që me Aktvendim nr. 08-258 nga 13.02.2019 të Komisionit për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik është pranuar.

-Në lidhje me ankesë të deklaruar nga kërkuar – person fizik, kundër Përgjigjes së Gjykatës supreme të RM nga 13.06.2018, me të cilën pozitivisht është përgjigjur për kërkesën për qasje të lirë në informatat me karakter publik, të regjistruar në GJSMV më 1.06.2018, Gjykata supreme e RM më datë 06.07.2018, në Komisionin për mbrojtje të së

drejtës për qasje të lirë në informatat me karakter publik dorëzoi Përgjigje të ankesës me shkresat e lëndës. Komisioni me aktvendim nga data 13.02.2019, ankesën e kërkuarit e aprovon dhe obligon Gjykatën supreme të RM që kërkuarit të ia dorëzojë informatën e kërkuar, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Aktvendimi i Komisionit është dorëzuar në Gjykatën supreme të RMV më datë 04.03.2019. Duke vepruar sipas obligimit të dhënë në aktvendimin e Komisionit, Gjykata supreme e RMV më datë 15.03.2019, me Përgjigje të kërkesës i dorëzoi drejtuar kërkuarit informatat e kërkuara, në mënyrë dhe në formë të theksuar në kërkesën.

8. Numri i ankesave të ri destinuara të shkallës së parë pas veprimit të Agjencisë;

- **nuk ka**

9. Numri i ankesave të refuzuara nga Agjencia dhe arsyet për refuzimin e tyre dhe

- **nuk ka**

10. Numri i ankesave të anuluar nga Agjencia dhe arsyet për anulimin e tyre;

- **nuk ka**

VËREJTJE: detyrat e shënuara gjithëpërfshirëse nga neni 36 nënkuptojnë edhe detyrë e Juaj që për të njëjtat të përgjigjeni saktë, me të dhënat, komentet dhe karakteristikat që dalin nga puna Juaj.

Shkup, 22.01.2020

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT

UD KRYETAR
Mr. Faik Arslani

(Posedues i informatave – vula)

Fidaije Alidemi
(personi zyrtar – nënshkrimi)